



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 145, datë 30.07.2018**

**PËR**  
**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË**  
**“CREDINS INVEST” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe nenit 12 dhe 14 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjen e investimeve kolektive”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5 të statutit të shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive “Credins Invest” sh.a, si më poshtë:

*“5.1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 95,822,394.00 lekë i përbërë prej 233,713.17 aksione me vlerë nominale 410 (katërqinddhjetë) Lek secili.*

*5.2. Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para (likuide) dhe zotërohet nga aksionarët e shoqërisë si më poshtë vijon:*

*a) Pjesëmarrja aksionare e Bankës Credins sh.a është në nivelin 76.00 % të kapitalit aksionar me barazvlerën në lekë prej 72,825,019.00 lekë, si dhe me 177,622.00 aksione;*

*b) Pjesëmarrja aksionare e SICRED sh.a është në nivelin 24.00% kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 22,997,375.00 lekë, si dhe me 56,091.17 aksione.”*

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**